



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1041/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Botek” Sh.P.K., me NRB:..., me seli në Prishtinë, Rr.”Agim Ramadani” p.nr, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. D., avokat në Prishtinë Rr. “UÇK” Hy.68, nr.1, kundër debitorit Ministria e Mbrojtjes, me seli në Prishtinë, Kazerma Adem Jashari, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.77/21 të datës 12.04.2021, të Përbaruesit Privat Afet Mjeku nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 20.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Ministria e Mbrojtjes i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Afet Mjeku.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.77/21 i datës 12.04.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Afet Mjeku.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Botek” SH.P.K, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.77/21 të datës 12.04.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës Nr.220221/2 e datës 22.02.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur shumë prej 8,773.94 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të pagesës së faturës, dhe shpenzimet për përpilim të propozimit për përbarim në shumë prej 104.00 euro, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, për faktin se bazuar në kontratën e lidhur në mes palëve afati kohor për dorëzim do të jetë 90 ditë nga momenti i marrjes së urdhërit të blerjes, jo më vonë se 15.12.2021, dhe sipas menaxherit të kontratës janë të paraqitura ditët e vonesës sipas liferimeve siç prezantohet në raportet e pranimit nga menaxheri i kontratës. Ka shtuar se debitori ka përmbushur obligimin financiar sipas kontratës ndërsa sa i përket pretendimit për borxhin e pa paguar, ju kujtojmë se për shumat e pretenduara të kreditorit është bërë ndëshkimi për vonesat në përmbushje të kontratës nga ana e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se pretendimet e debitorit se me mos pagesën e shumës prej 8,773.94 euro duke u bazuar në nenin 16 të kontratës e ka penalizuar kreditorin për shkak të vonesës së dërgesës së mallit të porositur, për të cilën vonesë kreditori e ka njoftuar debitorin se shkaqet e vonesës së dërgesës së mallit vijnë si pasojë e Corona Virusit Covid-19. Ka shtuar se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka nxjerr njoftim me të cilin ka obliguar të gjitha autoritet kontraktuese të mos i penalizojnë operatorët ekonomik ose të mos ndërmarrin masa tjera të përgjegjësisë kontraktuale në lidhje me operatorët ekonomik për vonesat me kryerjen e kontratave publike, nëse kontraktuesit vërtetojnë se ato vonesa janë për shkak të covid-19. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor, dhe të obligohet debitori që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën me Nr.220221/2 e datës 22.02.2021, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentet e besueshme respektivisht fatura e lartcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat është dorëzuar në origjinale nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë, për më tej debitori ka bërë pagesën e pjeshme të obligimit sipas faturës objekt i përmbarimit, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim sa i përket vonesave në furnizim me mall të porositur, dhe si pasoj për shumën objekti i përmbarimit debitori duke vepruar sipas kontratës ka bërë kalkulimin dhe ndëshkimin ndaj kreditorit për vonesat në përmbushje të kontratës, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se urdhri për përmbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1041/22, datë 20.11.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.